



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 12, datë 17. 07. 2009

**PËR
“RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË SË
TIRANËS PËR VITIN 2009 DHE PËR PËRDORIMIN E FONDIT
REZERVË”**

Mbështetur në nenin 19, pika 9 dhe nenin 32, “gërma “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, (i ndryshuar); nenin 44, paragrafi i dytë dhe nenin 6 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKB-në nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë një shtesë fondi investimesh në Programin e Investimeve të Rinisë e Sportit në shumën 12.700.000 lekë. Kjo shumë shton buxhetin për investime të Klubit të Futbollit Tirana për vitin 2009 sipas tabelës Nr.1 pjesë përbërëse e vendimit.
2. Efektet financiare të pikës 1 do të përballohen në shumën 7.998.000 lekë duke pakësuar fondin e investimeve të reja në nënprogramin e investimeve në kulturë dhe turizëm, si dhe 4.702.000 lekë duke pakësuar fondin rezervë të Bashkisë së Tiranës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Klubi i Futbollit Tirana, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Menaxhimit të Shërbimeve të Infrastrukturës .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R